



Në bazë të Nenit 11.3 b të Rregullores mbi Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës Nr-200/45 nenit 12.2 të Udhëzimit administrative Nr-2007/02 për të hyrat vetanake të komunave, nenit 39 të Statutit të Komunës së Suharekës pas Çertifikimit të draftit të Rregullores komunale të tarifave, ngarkesave dhe gjobave nga ana e komisionit përkatës të përbërë nga MEFI-I dhe MAPL-ja , Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur më 28.09.2007 muar këtë:

RREGULLORE

PËR

TARIFAT, NGARKESAT DHE GJOBAT NGA SHERBIMET DHE VEPRIMTARIT KOMUNALE.

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet lartësia e tarifave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime nga veprimtaritë komunale, që do t'i paguajnë personat fizikë dhe juridikë, në emër të shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale.

Neni 2

Lartësia e ngarkesave që do të paguajnë personat fizikë e juridikë, në emër të shërbimeve apo veprimtarive komunale sipas drejtorive, në pajtim me këtë Rregullore, do të jenë, si vijon: